



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 927/5 prot.

Datë 09.06.2022

**V E N D I M**

**Nr. 542/2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.06.2022 shqyrtoi kërkesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Preka” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-18483-02-02-2022, me objekt “*Blerje matësa elektronike njëfazore*”, me fond limit 107,879,200, lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.04.2022, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH Tiranë. Lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “Vuho” SHPK nga procedura e mësipërme e prokurimit.

**Ankimues:** Ligus SHPK  
Rruga Mark Bezati, Pallati Jora, Kashar

**Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria Rajonale e OSSH Tiranë  
Rruga “Reshit Petrela” Perballe Dispanserise, Tiranë

**Subjekt i Interesuar:** Operatori ekonomik “Preka” SHPK  
Lagjja 3 Heronjte, Rruga Marin Biçekemi, godine 2-katëshe, nr 5/247+2-2 , Shkodër

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlëra limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 03.02.2022, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-18483-02-02-2022, me objekt “**Blerje matësa elektronike njëfazore**”, me fond limit 107,879,200, lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.04.2022, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH Tiranë.

II.2. Në datën 04.04.2022 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 15.04.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Vuho 2018” SHPK	85.160.075 lekë, skualifikuar
2. “Preka” SHPK	<b>86.303.360 lekë, kualifikuar</b>
3. “Ligus” SHPK	<b>96.739.500 lekë, kualifikuar</b>
4. “Pre-Vla-Ku” SHPK	97.091.280 lekë, skualifikuar

II.4. Në datën 26.04.2022, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE, Njoftimin e Fituesit për procedurën e prokurimit dhe është publikuar njoftimi i fituesit në Buletinin Nr. 56 datë 04.05.2022, prej të cilit rezulton fitues operatori ekonomik “Preka” SHPK.

II.5. Në datën 04.05.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 927 prot., e operatorit ekonomik “Ligus” SHPK për procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-18483-02-02-2022, me objekt “*Blerje matësa elektronike njëfazore*”, me fond limit 107,879,200, lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.04.2022, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH Tiranë. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertave të operatorit ekonomik “Preka” SHPK.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 927/2 prot., datë 05.05.2022 lidhur me kriteret për të cilat ky i fundit pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Preka” SHPK, i kualifikuar në procedurën e mësipërme të prokurimit. Gjithashtu operatori ekonomik ankimues pretendon si dhe lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “Vuho” SHPK nga procedura e mësipërme e prokurimit.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 1915/3 prot., datë 12.05.2022, protokolluar me tonën me nr. 927/3 prot., datë 16.05.2022 me objekt “*Kthim përgjigje*” është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik informacion lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Ligus” SHPK dhe me shkresën nr. 1915/3 prot.,

datë 12.05.2022, e ka njoftuar atë se ka vendosur **mospranimin e ankesës** për sa i përket kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Preka” SHPK .

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ si dhe sistemit të ankesave elektronike rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, e konkretisht “Preka” shpk ka depozituar argumente (shkresa nr. 3282 prot datë 17.05.2022 përcjellë pranë KPP-së nga Agjencia e Prokurimit Publik pasi rezulton të jetë dërguar gabimisht pranë këtij institucioni), në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Ligus” SHPK për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Preka” SHPK me arsyetimin se *“1.Duke qënë se shoqëria jonë është një shoqëri lider në fushën e tregtimit të materialeve objekt prokurimi për të cilën disponon ndër vite kontrata të ngjashme, kemi bindjen që operatori ekonomik “Preka” shpk nuk ka vërtetuar eksperiencë të ngjashme në masën 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës sqë prokurohet të realizuara gjatë tre viteve të fundit. Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të procedurës së prokurimit si dhe kapacitetin e kësaj shoqërie pasi kemi investiguar në bilancet e tyre mbi volumin e shitjeve dhe të ardhurat nga aktiviteti (gjenden lehtësisht në faqe interneti) si dhe noohurive që disponojmë nga studimi i tregut jemi të bindur se operatori ekonomik i kualifikuar “Preka” shpk nuk disponon furnizime të ngjashme sipas pikës 2.2. kapaciteti teknik.*

*Referojmë kriterin për përvojën e ngjashme[...] . Autoriteti kontraktor për prokurimin “Blerje matësa elektronikë njëfazorë” kërkon të furnizohet me artikujt: matës elektronik një fazor 29.315 copë sipas specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Referuar kriterit të veçantë të kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë se kanë kryer furnizime të mëparshme, të ngjashme në natyrë me objektin e prokurimit. Në rastin konkret autoriteti kontraktor kërkon të prokurojë një mall i cili për nga natyra është specifik i veçantë, matësa elektronikë njëfazorë, materiale elektronike inteligjentë për matjen e energjisë dhe parametrave në kohë reale ku në bazë të historikut të kontratave të operatorit ekonomik të kualifikuar nuk disponon kontrata me zërin objekt furnizimi për zëra të tillë në funksion të përmbushjes në kriterin e veçantë të kualifikimit. Nga verifikimi në faqen open procurement <https://openprocurement.al>, e cila është e aksesueshme nga çdo individ apo shoqëri që kërkon informacione rreth operatorëve ekonomikw, vëmë re që operatori ekonomik “PREKA” SHPK, nuk ka asnjë kontratë të*

ngjashme me furnizime materiale sh të tilla nga viti 2015 deri më sot, por ka vetëm kontrata puniuesh. Të gjitha kontratat madje janë të realizuara në bashkëpunim JV me operatorë të tjerë, gjë që vë shumë në pikëpyetje aftësinë teknike të këtij operatori, dhe faktin se ky operator ekonomik nuk ka kontrata të ngjashme për këtë procedurë prokurimi, dhe aq më tepër furnizime të së njëjtës natyre dhe në vlerën e kërkuar. Kontratat e operatorit ekonomik “PREKA” SHPK, nuk mund të konsiderohen as si kontrata të ngjashme pasi nuk përmbushin karakteristikat e kontratës në natyrë, kompleksitet dhe metodologji. Natyra e objekteve të paraqitura nga OE nuk është e ngjashme pasi produkti është i ndryshëm. Produkti që kërkohet në objektin e prokurimit është mallra elektronike inteligjente — Matësa Elektronike Smart në funksion të infrastrukturës inteligjente të matjes e ngritur nga OSHEE SH.A. Ndërkohë kontratat që disponon operatori ekonomik i kualifikuar janë gjerësisht punime të infrastrukturës së transportit rrugor, ndërtimor, ujësjellës kanalizime, shkolla, bashki, ndricim i jashtëm etj. Kemi bindjen se vlera totale e kontratave të paraqitura nuk arrijnë të përmbushë vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor në kriterin e vecantë të kualifikimit në masën prej 40% të fondit limit, në përputhje me kriterin e vecantë të kualifikimit. Sa më sipër, operatori ekonomik “PREKA” SHPK nuk zotëron kapacitetet e nevojshme për të plotësuar dëshmitë për furnizime të ngjashme në vlerën e 40% të fondit limit sipas kriterit teknik pika 2.3 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe për këtë arsye oferta e tij ekonomike duhet të s’kualifikohet. (Qëndrime të ngjashme ka mbajtur KPP ndër vite në lidhje me vlerësimin mbi këtë kriter kualifikimi)”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “**2.2 Kapaciteti teknik**”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

**2.2.1.** Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) rezulton, se operatori ekonomik “Preka” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar:

- 1.Kontratë me objekt: “Linjë kabllore në Fidrin 17 dhe 9 me kabëll AL 3x (1x185)mm<sup>2</sup> N/Stacioni Shkodra 2”, BOE “Preka” SHPK 48% dhe “Junik” SHPK 52%.
- 2.Kontratë me objekt: “Rikonstruksion Linje Kabllore nga Kabina Kadija 1 deri tek Kabina Kullota, Zhvillim Rrjeti TM/TU Postribe, Rikonstruksion Rrjeti TU dhe Kabina murore Qendër Drisht dhe Shtyllore e Re Kalaja e Drishtit, Rikonstruksion i Rrjetit TU dhe Kabinës Qendrore Shtoj, Shkodër, BOE “Preka” SHPK 30% dhe “Ndërtuesi 2014” SHPK 70%.
- 3.Kontratë me objekt: “Ndriçim i rrugës Fermentim-Ura Bardhajve” Bashkia Shkodër, BOE “Preka” SHPK 35% dhe “Junik” SHPK 65%.
- 4.Kontratë me objekt: “Ndriçim i rrugës Harku i Berdices-Bacallek”, BOE “Preka” SHPK 53% dhe “Junik” SHPK 47%.
- 5.Kontratë me objekt: “Investime ndriçimi rrugë kryesore” Bashkia Shkodër, BOE “Preka” SHPK 60% dhe “Junik” SHPK 40%.
- 6.Kontratë me objekt: “Rikonstruksion i Pedonales Koplík Kab Box Koplík-1, Box Koplík-3, Box Koplík-E re 1 Fidri 2 Nst Bogic, Koplík”, BOE “Preka” SHPK 64% dhe “Junik” SHPK 36%.
- 7.Faturë nr. 18/2021, shitësi “Preka” SHPK dhe Blerësi “Ndertuesi 2014” SHPK.
- 8.Kontratë me objekt: “Rikonstruksion i Rrjetit Ajror TM 10Kv, Degëzimi Balldre-Torovice, F-12 Gjader, N/St Lezhë, BOE “Preka” SHPK 40% dhe “Ndërtuesi 2014” SHPK 60%.
- 9.Kontratë me objekt: “Rikonstruksion i Kabinave Rrjetit TU me ABC, në Fidrin 1 Trush, N/Stacioni 35/6 Kv Trush, BOE “Preka” SHPK 40% dhe “Ndërtuesi 2014” SHPK 60%.
- 10.Kontratë me objekt: “Rikonstruksion i Rrjetit TU dhe Kabinave Tresh 7, Spiten 2, Ded Alija, Pllane 2, Gajush 3, Gajush 1, Markatomaj 9, Markatomaj 3, Markatomaj 2, Fidri 10 Zejmen, N/St Lezhë, BOE “Preka” SHPK 40% dhe “Ndërtuesi 2014” SHPK 60%.

III.1.3. Në nenin 77, pikën 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.4. Në nenin 40, pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre

viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.1.5. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.6. Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt-shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të plotësojnë kushtin për të paraqitur dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Nga shqyrtimi i informacionit të depozituar me shkresën nr. 1915/3 prot., datë 12.05.2022 me objekt: “Kthim përgjigje” rezulton se, nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës është konkluduar që dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik pjesëmarrës “Preka” SHPK në procedurën e prokurimit, në përmbushje të kriterit sa më sipër cituar, është në përputhje me kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Konkretisht, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës në informacion e depozituar pranë KPP-së, në lidhje me këtë pretendim të ankimesit “Ligus” SHPK ka argumentuar se “Kontrata e paraqitura nga operatoi ekonomik “Preka” SHPK konsiderohen kapacitete të nevojshme për

*të plotësuar dëshmitë për furnizime të ngjashme në vlerën 40% të fondit limit. Megjithëse janë kontrata pune, kanë pjesë përbërëse Furnizim-Vendosje pajisje dhe materiale elektrike”.*

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon mbi dokumentacionin dhe informacionin e depozituar nga ana e autoritetit kontraktor “Drejtoria Rajonale e OSSH Tiranë, dokumentacionin të dorëzuar nga operatori ekonomik “Preka “ SHPK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) dhe në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Ligus” SHPK për kriteret, të cilat pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik pjesmarrës në procedurë “Preka” SHPK.

Komisioni sqaron se, referuar dokumentave standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se procedura e prokurimit me objekt: “*Blerje matësa elektronike njëfazore*”, në seksionin Njoftime është përcaktuar dhe evidentuar pika **1.7 Tipi i kontratës: Mallra.**

Për më tepër, Komisioni sqaron se, nga shqyrtimi i dokumentacionin të dorëzuar nga operatori ekonomik “Preka” SHPK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), konstatoi se dëshmitë për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës:

**Së pari** nuk janë kontrata malli por janë kontrata pune konkretisht me objekte: “*Linjë kabllore në Fidrin 17 dhe 9 me kabëll AL 3x (1x185)mm<sup>2</sup> N/Stacioni Shkodra 2*”, “*Rikonstruksion Linje Kabllore nga Kabina Kadaja 1 deri tek Kabina Kullota, Zhvillim Rrjeti TM/TU Postribë, Rikonstruksion Rrjeti TU dhe Kabina murore Qendër Drisht dhe Shtyllore e Re Kalaja e Drishtit, Rikonstruksion i Rrjetit TU dhe Kabinës Qendrore Shtoj, Shkodër, Ndriçim i rrugës Fermentim-Ura Bardhajve*” *Bashkia Shkodër, Investime ndriçimi rrugë kryesore*” *Bashkia Shkodër, Rikonstruksion i Pedonales Koplík Kab Box Koplík-1, Box Koplík-3, Box Koplík-E re 1 Fidri 2 Nst Bogic, Koplík, Rikonstruksion i Rrjetit Ajror TM 10Kv, Degëzimi Balldre-Torovice, F-12 Gjader, N/St Lezhë, Rikonstruksion i Kabinave Rrjetit TU me ABC, në Fidrin 1 Trush, N/Stacioni 35/6 Kv Trush, Rikonstruksion i Rrjetit TU dhe Kabinave Tresh 7, Spiten 2, Ded Alija, Pllane 2, Gajush 3, Gajush 1, Markatomaj 9, Markatomaj 3, Markatomaj 2, Fidri 10 Zejmen, N/St Lezhë”.*

**Së dyti**, kontratat e sipërcituara, kanë pjesë përbërëse Furnizim-Vendosje pajisje dhe materiale elektrike në funksion të realizimit të proceseve të punimeve ndërtimore/elektrike, duke demonstruar/provuar/treguar që ka blerë mallin apo pajisjen e nevojshme elektrike tek një blerës tjetër për realizimin e punimeve ndërtimore/elektrike dhe furnizuar me këto mallra si pjesë integrale të këtyre punimeve. Gjithashtu, referuar zërave të preventivave të kontrata të ngjashme pune të paraqitura nga operatori ekonomik “Preka” SHPK, KPP konstaton se, por këto pajisje dhe materiale elektrike në rastin konkret nuk janë mallra të ngjashëm me mallrat objekt prokurimi. Pra, operatori ekonomik “Preka” SHPK në rastin konkret nuk ka provuar me dokumentacion e nevojshëm sipas kriterit të kërkuar që është furnizues vetë apo distributor malli me natyrë të ngjashme me objektin e prokurimit, pavarësisht se në ekstraktin historik i regjistrit tregtar të operatorit ekonomik në fjalë, ka në objektin e veprimtarisë së tij *Punime elektrike të të gjitha llojeve instalimeve, projekteve etj. Tregtim i materialeve elektrike, tregtim me shumicë dhe pakicë, import-eksport, i artikujve të ndryshëm industrial,*



*ushqimore, konfeskione, makineri dhe pajisje, të pajisjeve elektro-shtëpiake, hidro-sanitare, transport për vete dhe të tretë.*

**Së treti**, Komisioni gjithashtu mori në shqyrtim edhe Faturë nr. 18/2021, me datë lëshimi 24.08.2021 ku konstatohet se shitësi është “Preka” SHPK dhe Blerësi është “Ndërtuesi 2014” SHPK, ku është evidentuar specifikim i hollësishëm i artikullit të faturës “*Situacion përfundimtarë “Ndërtim Kabina elektrike”, njësia matëse 1 (një)*”, shoqëruar dhe me një situacion përfundimtar me emërtimin “*Ndërtim për Kabina elektrike Panel i kompletuar + Matës elektronik*”, 1000 copë, me vlerë 22,609,144.2 pa TVSH (dhe me vlerë 27,130,973 me TVSH).

Referuar kriterit **2.2.1.** në dokumentat e tenderit, për dëshmitë e kontrata të ngjashme, është kërkuar që “*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara*”. Në përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik “Preka” SHPK ka dorëzuar Faturë nr. 18/2021, shitësi “Preka” SHPK dhe Blerësi “Ndërtuesi 2014” SHPK. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, nuk evidentohet të këtë sjellë dokumentacion provues shtesë për furnizimin e mallit *matës elektronik* por ka dorëzuar një situacion përfundimtar shoqëruar me faturën nr. 18/2021, ku në këtë të fundit identifikohet përshkrimi i mallit konkretisht me emërtimin “*Ndërtim për Kabina elektrike Panel i kompletuar + Matës elektronik*”, 1000 copë, me vlerë 22,609,144.2 pa TVSH (dhe me vlerë 27,130,973 me TVSH). KPP konstaton se, edhe kjo vlerë pa TVSH nuk arrin të plotësojë kriterin e veçantë të kualifikimit për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës (40% \*fondi limit 107,879,200 = 43,151,680 lekë pa TVSH) që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ku në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, *ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara*.

Komisioni gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor, që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në

dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Preka” SHPK, nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit në lidhje dëshmitë për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës nga autoriteti kontraktor qoftë me një enti publik apo sektorin privat.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Ligus” SHPK qëndron.

II.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Ligus” SHPK për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik pjesëmarës “Preka” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimi i mësipërm qëndron, pasi operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit në lidhje dëshmitë për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për furnizimet e mëparshme, të ngjashme dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të KPP do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

II.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Ligus” SHPK për lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “Vuho” SHPK nga procedura e mësipërme e prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, fati i kësaj shoqërie është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së të datës 15.04.2022, ku kjo shoqëri rezulton e skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi, e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit. Për më tepër, nga verifikimi i informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi administrativ në KPP, nuk rezulton që ky operator ekonomik të jetë ankimuar në lidhje me këtë procedurë prokurimi as në autoritet kontraktor dhe as në KPP.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik

gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

**Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Ligus” SHPK për procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-18483-02-02-2022, me objekt “*Blerje matësa elektronike njëfazore*”, me fond limit 107,879,200, lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.04.2022, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë operatorin ekonomik pjesëmarrës “Preka” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar, referuar konstatimeve të këtij vendimi, duke e skualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Ligus” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Fiorent Zguro**

**Anila Malaj**

**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**

**Jonaïd Myzyri**